

KONTRATE DHURIMI KUOTASH (KAPITALI)
TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

A2 shpk NUIS M42223011S

Sot me date 04/02/2025, palet si me poshte perpiluan kete kontrate dhurimi kuotash kapitali:

PALA DHURUESE

z.Asjen Isallari, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit karte identiteti me ID: K10216069E madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, dhurues i kuotave te shoqerise A2 shpk regjistruar ne Q.K.R. me NUIS M42223011S me adrese: Tirane Kamez University, Godina 6, Kati7, Apartamenti 14, Rruga Bashkim Shkurti.

PALA PRANUESE E DHURIMIT

z.Altjen Isallari, shtetas Shqiptar, mbajtës i letërnjoftimit karte identiteti me ID: K10216065S madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, pranues i kuotave te shoqerise A2 shpk regjistruar ne Q.K.R. me NUIS M42223011S me adrese: Tirane Kamez University, Godina 6, Kati7, Apartamenti 14, Rruga Bashkim Shkurti.

TE DHENAT PARAPRAKE

Sipas Ekstraktit te Regjistrimit Tregetar, eshte regjistruar subjekti A2 shpk regjistruar ne Q.K.B. me NUIS M42223011S me adrese ne Tirane Kamez University, Godina 6, Kati7, Apartamenti 14, Rruga Bashkim Shkurti. Kjo shoqeri eshte e perbere nga ortaku i vetem i kuotave **z. Asjen Isallari** zoterues me 100% te kuotave, me 1 kuote qe perben 100% te kapitalit te shoqerise, e cila eshte ne vleren 100.000 (njeqind mije) leke.

Sipas Vendimit Nr.02/2025 te Ortakeve te Shoqerise A2 shpk eshte vendosur dhurimi i 100% te kuotave ose 1 nje kuote e shoqerise nga **z. Asjen Isallari** te **z. Altjen Isallari**.

OBJEKTI

Dhurimi i 1(nje) kuote e cila perben 100% te kapitalit te shoqerise, e cila eshte ne vleren 100,000 (nje mije) leke, duke ja kaluar pales pranuese te dhurimit **z. Altjen Isallari**.

KALIMI I KUOTAVE

Me perpilimin e kesaj kontrate dhurimi kuotash (kapitali) te Shoqerise A2 shpk regjistruar ne Q.K.R. me NUIS M42223011S, ortaku **z Asjen Isallari** e humbet kete cilesi dhe ortak i vetem i shoqerise behet pranuesi i dhurimit te kuotave **z. Altjen Isallari**, e cili do kete ne zoterim 100% te kuotave te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar.



DETYRIMET E PALEVE

Pala dhuruese garanton palen pranuese te dhurimit, se kuotat e zoteruara prej tij jane te lira dhe mbi ato nuk rendon barre siguruese.

Pala pranuese e dhurimit duhet te regjistroje kalimin e kuotës, sipas ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Emertimi i shoqerise nuk do te ndryshoje.

LEGJISLACIONI I ZBATUESHEM DHE JURIDIKSIONI

Te gjitha mosmarreveshjet qe mund te lindin nga interpretimi ose zbatimi i kushteve te kesaj kontrate, jane objekt shqyrtimi dhe gjykimi para Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane.

INTERPRETIMI I KONTRATES

Kontrata duhet te interpretohet ne mirebesim nga palet.

Kontrata ose kushtet e saj interpretohen ne kuptimin ne te cilin mund te kete ndonje efekt dhe jo ne ate, sipas te cilit nuk do te kishte ndonje efekt.

BAZA LIGJORE

Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 „ Per tregtaret dhe shoqerite tregtare“, si dhe ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", Neni 761 e vijues i Kodit Civil.

Sa me larte u perpilua kjo Kontrate Dhurimi Kuotash (Kapitali) te Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar ne 4 (kater) kopje te njejta, dhe nenshkruhet prej paleve.

DHURUESI

z. Asjen Isallari



PRANUESI I DHURIMIT

z. Altjen Isallari

